



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1144/2 Prot.

Tiranë, më 20 / 08 / 2020

V E N D I M

Nr. 94, Datë 20 / 08 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 35, datë 20.05.2020, të H.Sh kundër Bashkisë Këlcyrë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shoqërore¹” dhe “çdo shkak tjetër²”. Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, H.Sh në mes të tjerash informon se: *“I është drejtuar disa herë me shkresa Bashkisë Këlcyrë, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit për ta pajisur me AMTP (Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi) dhe më pas dërgimin e këtij dokumentacioni në ZVRPP Përmet, për regjistrim, sipas Vendimit nr.220, datë 11.07.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Bashkia Këlcyrë në prani dhe të 8 personave të tjerë ka vulosur aktin e marrjes së tokës në pronësi për të gjithë të pranishmit. Më pas Bashkia Këlcyrë ka plotësuar dosjet për certifikim në hipotekë për personat³ e tjerë por nuk ka firmosur AMTP-në e tij, duke e trajtuar ankuesin në mënyrë të pabarabartë”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe plotësimin e dokumentacionit nga Bashkia Këlcyrë sipas vendimit të gjykatës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën,*

¹ Ankuesi shprehet se është pensionist, i ve, i sëmurë me zemër dhe në gjendje të vështirë ekonomike.

² Pa përcaktuar shkak.

³ Referuar Vërtetimit datë 14.08.2017 të shtetasit H.M.

ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkakun e pretenduar nga ankuesi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 35, datë 20.05.2020, të H.Sh kundër Bashkisë Këlcyrë, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 558/2, datë 22.05.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Këlcyrë për ankesën e bërë nga H.Sh.

Me shkresën nr. 958, datë 08.06.2020, Bashkia Këlcyrë ka dërguar parashtrimet si vijon: “Subjektit ankues i është rekomanduar që për tu trajtuar me tokë bujqësore dhe pajisur me AMTP duhet të ndjekë procedurën ligjore sipas VKM nr. 253, datë 06.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të AMTP për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore”. Ky rekomandim i është dhënë sa herë që H.Sh është paraqitur në bashki për tu pajisur me AMTP, praktikë kjo e ndjekur për çdo familje bujqësore që ka pretenduar për tu pajisur me AMTP. Pretendimi se është diskriminuar duke mos e trajtuar njësoj me shtetasin H.M⁵ nuk qëndron, pasi H.M ka lënë vullnetarisht një pjesë të sipërfaqes së tokës në vitin 1993 dhe më vonë pas vitit 2008 e ka përfutur me vendim gjykatë të formës së prerë. Për këtë rast, bashkia ka plotësuar dokumentacionin përkatës sipas procedurës ligjore. E njëjta procedurë do të ndiqet dhe për H.Sh”.

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁵ Referuar Vërtetimit datë 14.08.2017 të shtetasit H.M.

- Në përgjigje të shkresës së Bashkisë Këlcyrë, H.Sh me e-mail-in datë 14.06.2020 në mes të tjerash ka informuar se: *“Bashkia Këlcyrë nuk ka vullnetin për plotësimin e dokumenteve të AMPT-së, të kërkuar nga ankuesi, pasi nga vetë Kryetari i Bashkisë, është vënë vula e bashkisë tek dokumentet e 8 (tetë) personave⁶ të tjerë, që kishin të njëjtën problematikë me të (të gjithë me vendim gjykate të formës së prerë) ndërsa nuk plotësohen dokumentet e kërkuara nga H.Sh”.*
- Në vijim, Komisioneri me shkresën nr. 812, datë 24.06.2020, ka kërkuar nga Bashkia Këlcyrë parashtrime shtesë dhe dokumentet si më poshtë:
 - Shpjegime për rastet e përmendura nga ankuesi.
 - Kopje të vendimit të Gjykatës të formës së prerë për trajtimin me tokë bujqësore të personave: I.M, SH.L, S.L, H.XH, F.XH, I.M, J.M dhe A.Sh.
 - Kopje të kërkesës që kanë bërë personat e sipërpërmendur për t’u pajisur me AMTP.
 - Kopje të AMTP-së të personave të sipërpërmendur.

Referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR412756932AA, datë 27.06.2020 rezulton se Bashkia Këlcyrë, ka marrë dijeni për shkresën e mësipërme, në kushtet kur dokumenti është nënshkruar si nga punonjësi i institucioneve të mësipërme ashtu dhe nga nëpunësi i shërbimit postar.

Me shkresën nr. 1111/1, datë 29.07.2020 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar Bashkinë Këlcyrë me Vendimin nr. 77, datë 29.07.2020 në të cilin institucioni i Bashkisë Këlcyrë është gjobitur në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë për mosdhënien e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me shqyrtimin e ankesës së H.Sh.

Me shkresën nr. 2167, datë 06.08.2020, Bashkia Këlcyrë ka informuar Komisionerin, si vijon: *“Nga verifikimet e kryera në Bashkinë Këlcyrë, në lidhje me dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri për shtetasit: I.M, SH.L, S.L, H.XH, F.XH, I.M, J.M dhe A.Sh, rezulton se nuk ka dokumentacion për këta persona, me përjashtim të dokumentacionit bashkëngjitur të shtetasit J.M”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.

Procedura për trajtimin me tokë bujqësore dhe për tu pajisur me AMTP është e parashikuar në VKM-në Nr. 253, datë 06.03.2013 *“Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore”.*

⁶ I.M, SH.L, S.L, H.XH, F.XH, I.M, J.M dhe A.Sh.

Në pikën 23 të VKM-së së sipërcituar, përcaktohet se: *“Komuna/bashkia arkivon një kopje të AMTP-së, të shoqëruar me planvendosjen e saj dhe dokumentacionin përkatës sipas pikës 17 të këtij vendimi.....”*.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se autoriteti përgjegjës për të dërguar dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri, në kuadër të shqyrtimit të çështjes së H.Sh, është Bashkia Këlcyrë.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikon se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime dhe dokumentacion mbi mospajisjen me AMTP të shtetasit H.Sh dhe trajtimit të barabartë me personat e tjerë (I.M, SH.L, S.L, H.XH, F.XH, I.M) në mënyrë që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të kishte një bazë krahasimore dhe të shqyrtonte këtë ankesë me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe të argumentuar në ligj për konstatimin ose jo të diskriminimit. Komisioneri konstaton se Bashkia Këlcyrë me dijeninë e plotë dhe pas sanksionit me gjobë të dhënë nga Komisioneri me Vendimin nr. 77, datë 29.07.2020, nuk ka dërguar dokumentacionin dhe nuk ka dhënë informacionin e kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminim.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në pamundësi të sigurimit të dokumentacionit për krahasimin e ankuesit me personat e tjerë, është vënë në situatën e pamundësisë për të arritur në konkluzionin mbi trajtimin e njëanshëm, të pafavorshëm apo jo të ankuesit krahasuar me shtetas të tjerë, të ndodhur në kushte të njëjta apo të ngjashme.

Mungesa e dhënies së informacionit, ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rezultatet e shqyrtimit të çështjes dhe marrjen e një vendimi brenda afatit ligjor.

Për sa më sipër, në mungesë të dokumentacionit për të vërtetuar situatën diskriminuese të pretenduar nga subjekti ankues dhe në mbështetje të nenit 95, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilën parashikohet: *Pamundësia në objekt apo qëllim: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi pushimin e shqyrtimit të çështjes.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 95, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 32/1, gërma a), si dhe nenit 33, pikat 10 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Ndërprerjen e procedurave hetimore dhe pushimin e shqyrtimit të çështjes lidhur me ankesën e shtetasit H.Sh, për shkak të pamundësisë për të siguruar informacionin e nevojshëm për marrjen e një vendimi përfundimtar.
2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 77, datë 29.07.2020 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTORE JURIDIKE**

Ardiana HALA